



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:017323

Datë: 04.07.2023

Numri i dokumentit: 04450867

C.nr.327/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore N.D. në çështjen juridike kontesimore të paditësit E.B. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë Rr.”2 Korriku” nr.4 me objekt të kontestit për kompensim dëmi, dhe vlerë të kontestit 3.000,00 euro, me datë 04.07.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se padia e paditësit E.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë Rr.”2 Korriku” nr.4 me objekt të kontestit padi për kompensim dëmi dhe vlerë të kontestit 3.000 euro, është **tërhequr**.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është inicuar procedura civile sipas padisë së paditësit E.B. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me seli në Prishtinë Rr.”2 Korriku”, nr.4 me objekt të kontestit padi për kompensim dëmi dhe vlerë të kontestit 3.000 euro.

Përmes parashtrësës së datës 03.07.2023 i autorizuari i paditësit avokat A.K. nga Prishtina, e informojë gjykatën se kanë arritur marrëveshje jashtë procedurës gjyqësore me të gjitha format e dëmit material dhe jo material të precizuara në padi, dhe me pagesën e këtyre shumave konsiderohet se në tërësi janë përmbushur detyrimet e të paditurës dhe nuk kanë asnjë kërkesë shtesë andaj edhe paditësi hjeq dorë nga padia dhe kërkesë padia.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261 pika 2 dhe 3 të LPK-së, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se paditësi e ka tërhequr padinë.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.327/22 datë 04.07.2023

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.